

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“Aliaj & Kumrija STUDIO ” SH.P.K**

Sot, me date 23 Korrik 2018, ne Tirane, duke vepruar me cilesine e ortakëve themelues shtetasit:

1. **Saimir Kumrija**, shtetas shqiptar, I lindur me 28.08.1984 ne Gostime – Elbasan, Banues ne Elbasan Lagja 11 nentori Rruga I.Dinci pallati 580/2 I pajisur me Pashaporten me Nr. Personal I40828076U, madhor me zotesi te plote per te vepruar;
2. **Besmir Aliaj** , shtetas shqiptar, i lindur me 20.10.1991 ne Balles ,Fier, Banues ne Tirane. Rruga Myslym Shyri pallati 52/2 I pajisur me Pashaporten me Nr. Personal J11020110K, madhor me zotesi te plote per te vepruar;
3. **Ednor Aliaj** shtetas shqiptar, i lindur me 07.09.1982 ne Fier,Banues ne Tirane Ish.Blllok Rruga Brigada 8 pallati 2 kati 11 I pajisur me Pashaporten me Nr. Personal I20907086P madhor me zotesi te plote per te vepruar;

vendosen te themelojne Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar **“Aliaj & Kumrija STUDIO” SH.P.K**, dhe vendosen te aprovojne kete Akt Themelimi dhe Statutin e Shoqerise sipas termave dhe kushteve te meposhtme:

**TITULLI I**

**EMRI I SHOQERISE - REGJIMI JURIDIK - SELIA – KOHEZGJATJA**

**NENI 1 - Emri i Shoqerise**

**1.1** Ne perputhje me legjislacionin shqiptar, eshte krijuar Shoqeria **“Aliaj & Kumrija STUDIO” SH.P.K**, ne vijim referuar si “Shoqeria”.

**1.2** Shoqeria ka logon dhe vulen e vet zyrtare.



## NENI 2 - Regjimi Juridik i Shoqerise

**2.1 “Aliaj & Kumrija STUDIO” SH.P.K,** eshte nje Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar.

**2.2** Aktiviteti i saj eshte i organizuar sipas dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit dhe dispozitave ligjore ne fuqi mbi tregtine dhe legjislacionin civil ne Republiken e Shqiperise.

**2.3** Me vendim te Asamblese se Pergjithshme, Shoqeria mund te ndryshoje regjimin e saj juridik, ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi dhe dispozitat e Statutit te saj.

**2.4** Shoqeria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar.

## NENI 3 - Selia

**3.1** Shoqeria ka seline e saj ne adresen: Rruga “Reshit Collaku”, Pallatet Shallvare, Shkalla 4, Apartamenti 45.Tirane, Shqiperi

**3.2** Shoqeria mund te hape ose te mbylle dege, filiale dhe / ose zyra perfaqesimi brenda Shqiperise dhe / ose jashte vendit, ose te krijojte shoqeri te tjera me Partnere apo Aksionare pjesemarres.

## NENI 4 - Kohezgjatja

**4.1** Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise eshte e pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqerise ne Regjistrin Tregtar. Ortaku/et e Shoqerise mund te vendosin te kufizojne kohezgjatjen e aktivitetit me nje vendim te Asamblese se Pergjithshme.

## TITULLI II

### OBJEKTI

## NENI 5 - Objekti

**5.1** Objekti kryesor i Shoqerise do te perfshije, por nuk do te kufizohet vetem ne veprimtarite e meposhtme:



Shitblerje,huamarrje,huadhenie imobiliare per vete dhe per te trete; trasport te mallrave te ndryshem per perdorim e llogari vetjake dhe te paleve te treta brenda dhe jashte vendit; Tregtim te produkteve ushqimore, ,perpunim,amballazhim,paketim dhe shitjen e tyre me shumice dhe pakice.Kultivim,grumbullim,perpunim,amballashim,tregtim per import dhe eksport te bimeve farmaceutike ne vecanti dhe te bimeve ne pergjithsi Sherbimi i konsulences juridike, Auditime mjedisore; Pergatitjen e dokumentave per pajisje me leje mjedisi te tipit A, B, C; Hartim i Raporteve VNM te thelluar; Hartim i Raporteve VNM paraprake; Dhenien e konsulences mjedisore si dhe implementimin e sistemeve ISO (9001, 14001, 22001, 28000) HASAP (siguri ushqimore); Deratizim, dezinfektim si dhe dezinfektim. Konsulence ne veprimtarine e projektimit dhe te hartimit te planeve te menaxhimit te pyjeve dhe perdorimit te lendes drusore, konsulence ne fushen e arredimit, mobilimit te ambjenteve, zyrave...etj Projektim dhe instalim i pajisjeve elektrike,projektim dhe instalim i impjanteve hidraulike, projektim dhe instalime i projekteve mbi sigurine teknike ne pune . Pastrimin e ambjenteve publike e private. Shitja dhe blerja e materialit drusor te paprere, shfrytezimin e pyjeve, te prodhimeve te dyta pyjore etj. Sherbime katering, organizime festive, kokteje, koncerte, panaire, etj Tregtim, importim dhe eksportim i te gjitha llojeve te mallrave, materialeve, automjeteve, makinerive, pajisjeve dhe impjanteve te ndryshme te karakterit publik, industrial, bujqesor, tregtar, kulturor, sportiv dhe te sherbimeve, pjese kembimi, goma te ndryshme, bateri automjetesh e te tj.Tregti me shumice e pakice te artikujve te ndryshem industriale, bujqesore, bimeve medicinale,produkteve ushqimore, materiale ndertimi, pesticide, pajisje elektronike, e te tjere Tregti te vjarave lubrifikante,Marrje me qera,menaxhim bare,restorant, sallon mode, servis makinash, lavazh, agjensi turistike,resorte turistike,agroturizem dhe agrobiznez etjTregti te pajisjeve elektronike, kompjutera, aksesore, kancelari. Tregtim materiale elektrike dhe pajisje laboratorike Sherbime mirembajtje dhe servise te ndryshme per materialet e pajisjet elektrike dhe industriale. Tregtim i lendeve djegese dru zjarri, briket, pellet dhe solar Shoqeria mund te marre pjese ne cilesine e ortakut apo te aksionerit ne shoqeri te tjera tregtare me objekt te njejte ose te ndryshem, ne perputhje me legjislacionin Shqiptar, ne menyre qe te arrije objektin e lartpermendur;



Shoqeria mundet gjithashtu:- Te kryeje cdo transaksion lidhur me asetet e luajtshme ose pasurite e paluajtshme, vendosja e pengjeve, hipotekes, barreve si dhe aktivitete te cilat mund te konsiderohen te nevojshme per te realizuar aktivitetin e Shoqerise.

Per me teper Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet tjeter i cili nuk eshte i ndaluar nga ligji ne fuqi, qe sjell perfitime dhe eshte ne interes te Shoqerise.

### **TITULLI III**

## **KAPITALI I SHOQERISE - TRANSFERIMI I KUOTAVE- ZMADHIMI I KAPITALIT**

### **NENI 6 – Kapitali i Shoqerise**

**6.1** Kapitali i shoqerise eshte ne vleren 1.000.000 LEK ( nje milion leke ) i ndare ne 3 (tre) kuota.

Kapitali i shoqerise do te paguhet plotesisht nga ortakët themelues si vijon:

- a) Z. Saimir Kumrija, nenshkruer i 1 (nje) kuote, qe perfaqeson 34% te kapitalit te shoqerise, me nje vlere prej 340.000 LEK;
- b) Z. Besmir Aliaj , nenshkruer i 1 (nje) kuote, qe perfaqeson 33% te kapitalit te shoqerise, me nje vlere prej 330.000 LEK;
- c) Z. Ednor Aliaj, nenshkruer i 1 (nje) kuote, qe perfaqeson 33% te kapitalit te shoqerise, me nje vlere prej 330.000 LEK;

**6.2** Pergjegjësia e Ortakeve ndaj paleve te treta per detyrimet e marra persiper nga kompania eshte e kufizuar sipas pjesemarrjes se ortakut ne kapitalin e shoqerise.



## NENI 7 - Transferimi i kuotave

7.1 Transferimi i kuotave te shoqerise ndaj paleve te treta i nenshtrohet se drejtes se parablerjes ne favor te ortakeve te tjere te cilet mund ta ushtrojne kete te drejte sipas kushteve te percaktuara ne nenin 7.2 deri ne nenin 7.6 me poshte.

7.2 Ne rast se nje ortak "Ofruesi" kerkon te shese dhe/ose te transferoje disa ose te gjitha kuotat e tij, ortaket e mbetur ("Ortaket e mbetur") do te kene te drejten e parablerjes ne lidhje me kuoten qe ofrohen per transferim ("Kuota e ofruar"), sipas kushteve te meposhtme:

(a) Ofruesi do tu dergoje fillimit ortakeve te mbetur nje njoftim me shkrim i cili percakton perqindjen e kuotes se ofruar , cmimin dhe kushtet e tjera te transferimit te cilat duhet te pershijne Identitetin e Bleresit ("OFERTA"), duke ftuar se pari Ortaket e mbetur te blejne aksionet e ofruara;

(b) Ortaket mbetur do te kene te drejten te blejne kuotat e ofruara perpjestimisht dhe sipas kushteve te ofertes, duke i derguar nje njoftim me shkrim ofruesit brenda nje afati prej tridhjete (30) ditesh pas marrjes se njoftimit te Ofuesit.

7.3 Ne rast se me shume se nje prej Ortakeve te mbetur deshirojne te blejne kuoten e ofruar, secili prej ketyre ortakeve te mbetur do te kete te drejten te bleje kuoten e ofruar perpjestimisht sipas perqindjeve qe zoterojne ne Shoqeri, duke i derguar nje njoftim me shkrim ofruesit brenda nje periudhe prej tridhjete (30) ditesh nga marrja e njoftimit sipas se cilit secili prej tyre deshiron te bleje kuoten e ofruar.

7.4 Ne rast se asnje nga ortaket e mbetur nuk deshiron te bleje kuoten e ofruar dhe/ose kane refuzuar te blejne kuoten e ofruar, sipas kushteve te percaktuara ketu, brenda tridhjete diteve nga marrja e ketij njoftimi, Ofruesi do te kete te drejten ti transferoje Kuotat e ofruara nje pale te trete me te njetin cmim qe i eshte ofruar ortakeve te mbetur (sipas kushteve te ofertes fillestare). Nese ky kusht nuk eshte permbushur, Marreveshja per Shitjen e Kuotave me palet e treta do te jete e pavlefshme.

7.5 Ne rast se ndonje ose te gjitha ortaket e shoqerise blen/blejne kuotat e ofruara sipas kushteve te ofertes, sic percaktohet me siper, ky transferim do te kryhet sipas kushteve te ofertes.





7.6 Kushtet e parashikuara me siper nuk do te zbatohen ne rast transferimi te kuotave nga nje ortak tek nje shoqeri e cila ndodhet nen kontrollin e ketij ortaku ose ne rast transferimi nga nje ortak tek nje pasardhes ose pasardhes i drejperdrejte i tij ose tek bashkeshorti.

7.7 Dispozitat e neneve 7.1- 7.6 , nuk do te zbatohen ne rast transferimi te bere ne favor te ortakeve te tjere. Megjithate, ne kete rast transferimi duhet ti komunikohet fillimisht me shkrim ortakeve te tjere. Te gjitha njoftimet sipas ketij neni duhet ti dergohen edhe Shoqerise.

### **NENI 8 - Rritja e Kapitalit**

8.1 Asambleja e Pergjithshme mund te rrise kapitalin e shoqerise, ne perputhje me kuorumin e percaktuar ne nenin 12 te ketij Akt Themelimi dhe Statuti.

8.2 Ne rast te nje rritje te kapitalit, ortaket kane te drejte te nenshkrimt te kuotave nepermjet kontributit ne natyre ose ne te holla, ne proporcion me perqindjen qe gezojne ne kapitali e shoqerise.

8.3 Nese ndonje nga ortaket refuzoje te drejten nenshkrimt, kapitali mund te nenshkruhet nga ortaket e tjeter. Ne kete rast, ortaket e tjere mund te ushtroje te drejten e tyre per nenshkrimin e kapitalit ne proporcion me perqindjen qe gezojne ne kapitalin e shoqerise.


### **NENI 9 - Zvogelimi i Kapitalit**

9.1 Asambleja e pergjithshme mund te zvogeloje kapitalin e shoqerise, ne perputhje me kuorumin e percaktuar ne nenin 12 te ketij Akt Themelimi dhe Statuti. Ne çdo rast, kapitali nuk mund te reduktohet nen vleren minimale te percaktuar me ligj.

9.2 Ortaket perballen me uljen e kapitalit te shoqerise ne proporcion me kuotat e zoteruara nga secili prej tyre ne kompani.

### **NENI 10 - Certifikata e pjesemarrjes**

10.1 Secili nga ortaket gezon te drejten nje certifikate ne lidhje me perqindjen ne pjesen qe gezon ne kapitalin e shoqerise. Shoqeria nuk eshte e detyruar te leshoje me shume se nje certifikate per kuotat e mbajtura se bashku nga disa Ortake dhe shperndarja e certifikates per perfaqesuesit e perbashket e



anetareve do te konsiderohet e dhene ne interes te te gjithë ortakeve, ne perputhje me dispozitat e ligjit.

## TITULLI IV

### ORGANET E SHOQERISE

#### NENI 11 - Organet e Shoqerise

**11.1** Organet e Shoqerise jane:

- 1) Asambleja e Pergjithshme;
- 2) Administratori / s.

#### ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

##### 1) Asambleja e Pergjithshme

**11.1** Asambleja e Pergjithshme eshte organi vendimmarres i Shoqerise dhe perbehet nga te gjithë Ortaket e Shoqerise.

**11.2** Çdo Ortak ka te drejte te marre pjese ne Asamblen e Pergjithshme per te shprehur mendimin e tij dhe te votoje ne baze te kuotave qe zoteron.

**11.3** Ortaku mund te perfaqesohet nga nje person tjetër, jo domosdoshmerisht Ortak/e, me ane te nje Prokure te Posacme. Ne çdo rast, kjo Prokure e Posacme mund te jepet vetem per nje Mbledhje te caktuar te Asamblese se Pergjithshme, dhe do te jete e vlefshme edhe per mbledhjet pasardhese me te njejtin rend dite. Administratorët nuk mund te perfaqesojne Ortakun ne mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme.

**11.4** Asambleja e Pergjithshme mund te mblidhet ne nje vend te ndryshem nga selia e Shoqerise, ne Republikën e Shqiperise ose jashte vendit.

**11.5** Asambleja e Pergjithshme thirret nga Administratori, sipas nevojave dhe interesave te Shoqerise ose nese kerkohet nga legjislacioni ne fuqi. Asambleja e Pergjithshme mund te thirret edhe nga cdo Ortak qe zoteron te pakten 10% (dhjete per qind) te pjeses se kapitalit. Ne çdo rast, Asambleja e Pergjithshme mblidhet te pakten nje here ne vit, brenda javes se fundit te muajit Maj, ne menyre qe te diskutoje, te shqyrtoje dhe te miratoje bilancin vjetor te vitit te kaluar fiskal. Mbledhja e pare e Asamblese se Pergjithshme, do te mbahet



brenda tre muajve nga dita e regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregtar per te diskutuar planin e biznesit dhe çeshtje te tjera.

**11.6** Njoftimi per mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme do te behet me leter rekomande me njoftim marrjeje, dhe do te dergohet ne adresat e Ortakeve te shoqerise te regjistruara ne Regjistrin e Ortakeve, ose me poste elektronike ne adresat e Ortakeve, ose me poste tek Ortaket se paku 21 (njezet e nje) dite perpara dates se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme.

**11.7** Njoftimi duhet te permbaje informacion mbi ceshtjet qe do te diskutohen ne rendin e dites dhe mbi te cilat do te merret vendim, vendin, oren dhe daten e thirrjes se pare dhe te dyte, si edhe procedurat e detajuara te pjesemarrjes dhe te votimit, informacion mbi vendin dhe menyra e marrjes se dokumentacionit dhe projekt vendimeve te asamblese si edhe elementet e tjera te percaktuar nga legjislacioni ne fuqi.

**11.8** Asambleja e Pergjithshme do te konsiderohet e mbledhur rregullisht edhe nese nuk ka ndjekur te gjitha formalitetet e thirrjes, nese te gjitha Ortaket qe perfaqesojne pjesen e tere kapitalit te shoqerise jane te pranishem ne mbledhje apo te perfaqesuar nga nje perfaqesues me prokure te posacme, dhe shprehen dakort per te zhvilluar mbledhjen e asamblese pavaresisht parregullsive ne thirrjen e saj.

**11.9** Asambleja e Pergjithshme mund te mbahet edhe me pjesemarrjen e njerezve ne vende te ndryshme, dhe mund te mbahet permes telekonferences apo videokonferences, ose mjete te tjera te ngjashme elektronike, me kusht qe te gjitha pjesemarrjesit te mund te identifikohen dhe t'i jepet mundesia per te marre pjese ne diskutimet dhe per te marre pjese ne to.

**11.10** Asambleja e Pergjithshme kryesohet nga Kryetari i cili emerohet nga radhet e Ortakeve te pranishem ose te perfaqesuar ne mbledhje. Nese prezenca e nje noteri publik nuk eshte e nevojshme, Asambleja e Pergjithshme do te emeroje nje sekretar, i cili nuk duhet te jete domosdoshmerisht nje nga Ortaket.

**11.11** Kryetari i Mbledhjes ka kompetenca te plota per te kontrolluar prokurat e posacme dhe rregullsine e tyre, te drejten e Ortakeve dhe perfaqesuesve te tyre per te marre pjese ne Asamblene e Pergjithshme, si dhe per te percaktuar nese Mbledhja eshte thirrur rregullisht dhe nese kuorumi i nevojshem per marrjen e Vendimeve te vlefshme eshte arritur. Kryetari ka gjithashtu te drejten per te drejtuar diskutimet dhe per te percaktuar metodat dhe procedurat e votimit.



**11.12** Ne rast se Shoqeria ka vetem nje Ortak qe ka fituar Kuotat e Ortakeve te tjere me ane te nje procesi ligjor dhe zoteron tere kapitalin e shoqerise, vendimet e Ortakut te vetem do te regjistrohen ne regjistrin e vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose fshihen.

## **NENI 12- Kuorumi dhe Kompetencat e Asamblese se Pergjithshme**

**12.1** Ne rast vendimesh te zakonshme, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese jane te pranishem ortaket e shoqerise qe zoterojne me shume se 75% (shtadhjete e pese perqind) te Kuotave me te drejte vote. Nese Asambleja e Pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumi ne thirrjen e pare, asambleja mund te mblidhet perseri me te njejtin rend dite brenda dhe jo me vone se 30( tridhjete) dite pas thirrjes se pare. Vendimet e zakonshme merren me voten pro te shumices se ortakeve te pranishem apo te perfaqesuar.

**12.2** Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te zakonshme mbi ceshtjet e meposhtme:

- (a) percaktimin e politikave tregtare;
- (b) emerimin dhe shkarkimin e Administratorit;
- (c) emerimin dhe shkarkimin e eksperteve kontabel te autorizuar dhe likuiduesve;
- (d) miratimin e shperblimeve per personat per permendur ne paragrafet (b) dhe (c);
- (e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- (f) monitormin dhe mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga Administratori;
- (g) perfaqesimin e Shoqerise ne gjykate dhe ne proceset gjyqesore ndaj Administratorit;
- (h) cdo ceshtje tjeter te percaktuar nga ligji apo statuti.



**12.3** Ne rast vendimesh te jashtezakonshme, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese jane te pranishem ortaket qe zoterojne me shume se 75% (shtatedhjete e pese perqind) te kuotave me te drejte vote. Nese Asambleja e Pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumit ne thirrjen e pare, asambleja mund te mblidhet perseri me te njejtin rend dite brenda dhe jo me vone se 30(tridhjete) dite pas thirrjes se pare. Vendimet e jashtezakonshme merren me voten pro te te pakten  $\frac{3}{4}$  ( tre te katertat) e ortakeve te pranishem apo te perfaqesuar.

**12.4** Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te jashtezakonshme mbi ceshtjet e meposhtme:

- (a) ndryshimi apo plotesimi i Statutit te Shoqerise;
- (b) zmadhimi apo zvogelimi i kapitalit ose krijimin
- (c) shperndarjen e fitimeve vjetore nepermjet dividendeve dhe akordimin e aksioneve ne vend te dividendeve;
- (d) riorganizimin, shperndarjen, transformimin, bashkimin, shkrirjen, ndarjen, likujdimin apo prishjen e shoqerise si edhe riorganizimin e shoqerise ne nje forme tjeter;
- (e) ndermarrjen e cdo veprimi i cili pitet ne menyre te arsyeshme se do te coje ne likujdimin e shoqerise;
- (f) hapjen e nje dege, blerjen apo shitjen e nje dege me ose pa emer;
- (g) marrjen persiper te cdo detyrimi me nje vlere me te larte se 5% (pese perqind) te aktiveve totale te shoqerise sic rezulton nga pasqyrat e fundit financiare te audituara;

### **NENI 13 - Administratori**

**13.1** Asambleja e Pergjithshme do te caktojte nje (1) personi fizik si Administrator te shoqerise, i cili mund te jete ortak ose jo dhe qe do te jete pergjegjes per ceshtjet e perditshme te Shoqerise sipas kufizimeve te parashikuara nga ligji ne fuqi dhe me kete Statut.

Administratori ushtron keto detyra:



(a) menaxhon shoqerine duke zbatuar politikat siç percaktohet nga Asambleja e Pergjithshme;

(b) sigurohet qe te mbahen librat dhe dokumentet e nevojshme kontabel;

(c) Mban dhe nenshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise dhe ja paraqet ate Asamblese se Pergjithshme per miratim se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve;

(d) krijon nje sistem paralajmerimi te hershem ne lidhje me zhvillimet qe kercenojne ekzistencen e shoqerise;

(e) paraqet te dhenat e shoqerise per t'u regjistruar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas rastit;

(f) raporton perpara Asamblese se Pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe per realizimin e veprimeve me rendesi te veçante per punen e Shoqerise;

(g) cdo detyre tjeter siç percaktohet me ligj ose Statut.

**13.2** Administratori emerohet per nje periudhe deri ne 5 (pese) vite dhe me te drejte rizgjedhjeje. Ky emerim prodhon efekte ligjore ne daten e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

**13.3** Shoqeria merr angazhime me nenshkrimin e vetem te administratorit, sipas kufizimeve te parashikuara nga ligji ne fuqi dhe ne kete Statut dhe Akt Themelimi.

**13.4** Administratori i shoqerise ka te drejten dhe detyrimin per te perfaqesuar Shoqerine ne marredheniet me te tretet.

**13.5** Asambleja e Pergjithshme emerom si Administrator te shoqerise, **Z. SAIMIR KUMRIJA**, per nje afat 5 (pese) vjecar me te drejte rizgjedhje.

## TITULLI V

### VITI FINANCIAR, DIVIDENTI

#### NENI 14 - Viti Financiar

**14.1** Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti.



**14.2** Perjashtimisht viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit ne QKB (Qendra Kombetare e Biznesit) dhe perfundon me 31 Dhjetor te atij viti.

### **NENI 15 – Dividentet dhe Kapitalizimi i Fitimeve**

**15.1** Permes vendimit te asamblese se pergjithshme shoqeria shperndan dividendin ne perputhje me te drejtat perkatese te ortakeve, nese:

- a) aktivet e shoqerise mbulojne teresisht detyrimin e saj;
- b) shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te paguar detyrimet qe duhet te jene te pagueshme brenda 12 muajsh.

### **15.2 Kapitalizimi i Fitimeve**

Me vendim te Asamblese se Pergjithshme dhe ne lidhje me parimet e percaktuara ne nenin 14, te Ligjit 9901, date 14.04.2008 i ndryshuar, Ligj nr. 129/2014, administratori mund te vendose per te kapitalizuar fitimet.

## **TITULLI VI**

### **SHPERBERJA-NDARJA-BASHKIMI- LIKUIDIMI**

#### **NENI 16 - Prishja-Ndarja-Bashkimi**

**16.1** Shoqeria mund te priset per shkaqet e parashikuara me ligj. Ne rast te prishjes, Asambleja e Zakonshme e Ortakeve emerone nje ose me shume likuidatore duke u percaktuar kompetencat reciproke.

**16.2** Shoqeria gjithashtu mund te ndahet ose te bashkohet me ane te nje vendimi te asamblese se jashtezakonshme te ortakeve.

#### **NENI 17 - Likuidimi**

**17.1** Ne rast te prishjes shoqeria mund te likuidohet.

**17.2** Per te administruar kete procedure, Asambleja e Zakonshme e Ortakeve emerone nje ose me shume likuidatore i cili do te hartoje raportin perfundimtar mbi aktivet dhe pasivet e shoqerise, si dhe procedurat dhe kohen e duhur per likuidim.

**17.3** Ne fund te procedurave te likuidimit, Asambleja e Zakonshme e Ortakeve do te vendose ne lidhje me bilancin perfundimtar, punen e bere nga likuiduesi dhe te perfundoje procesin e likuidimit.



17.4 Me likujdimin e kreditoreve likuiduesit gjithashtu do te shperndajne aktivet e mbetura te Ortakeve ne proporcion me perqindjen qe ata disponojne.

## TITULLI VII

### NDRYSHME

#### NENI 18 - Gjuha dhe Zgjidhja e Mosmarreveshjeve

Çdo mosmarreveshje ose mosmarreveshjet ndermjet ortakeve ose ne mes tyre ne Shoqeri fillimisht do te zgjidhet ne menyre te brendshme dhe miqesisht. Nese, nje zgjidhje miqesore nuk mund te arrihet brenda 60 ditesh, çeshtja do t'i referohet gjykates kompetente ne Shqiperi.

#### NENI 19 - DISPOZITA TE FUNDIT

Ky Akt Themelimi dhe Statut u hartua ne 3 (tre) kopje ne gjuhen shqipe .

\*\*\*\*\*

### ORTAKET THEMELUES

SAIMIR KUMRIJA

BESMIR ALIAJ





EDNOR ALIAJ

